



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 14-2008  
Prishtinë, më 27 maj 2008, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi dhe Džezair Murati.

**Munguan:** Branislav Grbiq, Lutfi Haziri dhe Selviqe Halimi.

**Të ftuar:** Lumnije Murati - ZPK, Reshit Gashi - NDI, Hysni Ismajli - Departamenti Ligjor KK, Ramadan Islami - OSBE, Alberto Pasquero - OSCE, Sebiha Mexhuani - OSCE, Fitore Zeneli - KDI.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 6 majit 2008;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për ndërmjetësimin;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Projektligjin e procedurës përmbareuese;
5. Shqyrtimi i propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës;
6. Të ndryshme:
  - Shqyrtimi i kërkesës së Nerxhivane Dautit;

- Njoftimi i Komisionit për Analizën ligjore të OSCE-së për rastet e trafikimit me njerëz në Kosovë.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës dhe e propozoi ndryshimin radhës së pikave të rendit të ditës për ta shqyrtuar së pari Analizën ligjore të OSCE-së për rastet e trafikimit me njerëz në Kosovë. Me këtë propozim u pajtuan unanimitas anëtarët e Komisionit.

*Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.*

**Kryetari** i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi – I përshëndeti dhe i falënderoi për praninë përfaqësuesit të OSCE-së dhe ia dha fjalën z. Mark Laser që e paraqiti raportin me Analizën ligjore të OSCE-së për rastet e trafikimit me njerëz në Kosovë.

**Z. Mark Laser** - Në fillim të fjalës së vet i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi anëtarët e Komisionit për bashkëpunim. Më tutje tha se ky komision e ka mandatin për monitorimin e sistemit juridik në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ne, shtoi ai, po e paraqesim mandatin e Seksionit juridik për monitorimin e sistemit juridik në OSBE.

**Z. Laser** - Tha se do të donim t'ju dërgonim shumë raporte jo vetëm këto që kanë të bëjnë me këto trafikime, por do të bëjmë edhe shumë raporte në baza mujore dhe në çdo tre ose në katër muaj do të publikojmë raporte tematike. Ai tha se këtë raport e kemi publikuar në tetor 2007. Në raportet tona kemi konstatuar se shumë prokurorë e gjykatës janë joadekuatë në trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore. Gjithashtu tha se ka pasur shumë hetime joadequate dhe dështime. Mirëpo ka pasur raste që janë ndjekur si vepra penale ose si prostitucion.

Më tutje theksoi se është e nevojshme të krijohen kushte për mbrojtjen e dëshmitarëve si edhe të viktimave në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe në rastet e krimit të organizuar.

**Mark Laser** - Në fund tha se kjo ishte një përmbledhje e shkurtër e raportit dhe shprehu gatishmërinë për të dërguar edhe raporte të tjera dhe për të dhënë sqarime e rekomandime për ndryshime legjislative. Edhe një herë falënderoi për ftesën dhe shprehu gatishmërinë t'u përgjigjet pyetjeve që do t'i bëhen.

**Bahri Hyseni** - Falënderoi edhe një herë për paraqitjen e raportit dhe tha se konkluzionet në raport janë objektive. Mirëpo edhe ne si Komision do të bëjmë përpjekje që të dalim me propozime për institucionet e Kosovës për të nxjerrë legjislacion përkatës për ta rregulluar këtë çështje.

**Riza Smaka** – I përshëndeti të pranishmit dhe tha se prostitucioni është dukuri e dëmshme si për moralin ashtu edhe për shëndetin. Mirëpo duhet të bëjmë përpjekje për ta hartuar ligjin për prostitucionin, në mënyrë që me rregullativë ligjore të kontrollohet kjo dukuri dhe të vihet në binarë të asaj që mund të quhet tolerante, edhe pse jam shumë

skeptik për mundësinë e luftimit të kësaj dukurie. Kurse sa i përket zhvendosjes së dëshmitarit jam skeptik se mund të realizohet në një vend me dhjetëmijë km katrorë edhe po të bënim operim plastik.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 6 majit 2008**

**Kryetari** – I pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për ndërmjetësim**

**Kryetari** – I njoftoi të pranishmit se për këtë projektligj Komisioni e kishte propozuar Selvije Halimin raportuese, por ajo nuk i kishte sjellë amendamentet me shkrim dhe as nuk është paraqitur vetë, kështu që nuk i dimë arsyet e kësaj mungese. Prandaj propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Ai theksoi se nëse raportuesja nuk e bën punën për të cilën është obliguar, do ta marrë përsipër që ai vetë ta shqyrtojë dhe t'i paraqesë vërejtjet në Projektligj.

## **4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Projektligjin e procedurës përmbaruese**

Përkitazi me raportin e Projektligjit për procedurën përmbaruese, për të cilin u shkaktua konfuzion në seancën e kaluar të Kuvendit, kryetari i Komisionit bëri sqarime të nevojshme. Theksoi se këtu është e nevojshme të njoftohet Komisioni se me rastin e procedimit të raportit me amendamente, administrata kishte bërë një gabim teknik për të cilin nuk kemi qenë në dijeni dhe doli si problem që ishte i panevojshëm. Ne si komision, tha ai, kemi për obligim që edhe një herë të konstatojmë se raporti përfundimtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi është i datës 22 prill 2008 dhe se data 25 prill e shkruar në raport ka qenë vetëm një gabim teknik. Po ashtu sqaroi se amendamenti i 7-të është bërë amendamenti i 8-të për shkak të shtimit të një amendamenti gjuhësor.

*Të gjithë anëtarët e Komisionit u pajtuan që Projektligji për procedurën përmbaruese me amendamente të propozuara të procedohet për miratim sipas raportit përfundimtar të datës 22 prill 2008 në një nga seancat e ardhshme të Kuvendit.*

## **5. Shqyrtimi i propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës**

Me rastin e shqyrtimit të propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë përkitazi me formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, kryetari i Komisionit Bahri Hyseni, tha se i kemi disa paqartësi lidhur me këtë propozimvendim. Në propozimin e parë nr. 03/0432/Do-141 të datës 16. 04. 2008, Nerxhivane Dauti ishte propozuar zëvendësanëtare e Komisionit në lëndën e Drejta tregtare. Në ndërkohë nga Ministria e Drejtësisë erdhi raporti nr.03/0524/Do-286 i datës 6. 05. 2008 me të cilin

njoftohet Kuvendi i Kosovës se Nerxhivane Dauti ka hequr dorë nga propozimvendimi i lartpërmendur dhe në vend të saj për zëvendës të anëtarit të Komisionit, propozohet prof. dr.sc Robert Muharremi, ligjërues në Universitetin Amerikan të Prishtinës. Ai më tutje tha se në këtë rast për Komisionin është një paqartësi, sepse së bashku me propozimin për ndryshimin e vendimit Komisionit nuk i është ofruar teksti i dorëheqjes nga Ministria e Drejtësisë e paraqitur nga z. Nerxhivane Dauti. Nga zonja Dauti e kemi edhe një kërkesë drejtuar Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në të cilën theksohet se z. Dauti asnjëherë nuk ka ofruar dorëheqje, tha z. Hyseni. Këto paqartësi e vështirësojnë pozicionin e Komisionit për ta shqyrtuar propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe procedimin e tij për miratim në seancën e Kuvendit. Çështje tjetër është së ky propozimvendim nuk është në pajtim me nenin 7.6 të Ligjit për provimin e jurisprudencës.

Ai pati vërejtje edhe në pikën 3 të propozimvendimit, në të cilin Ruzhdi Berisha, avokat nga Prizreni, është propozuar pyetës për lëndën e Drejta civile. Nga CV-ja që kemi para nesh shihet se ai nuk e ka asnjërin nga titujt që kërkohen. Me ligj është përcaktuar se mund të ketë të drejtë të pyesë për lëndën e caktuar ai kandidat që 10 vjet ka punuar pa ndërprerë në lëndën e caktuar në gjykata. Mirëpo nga ajo që shohim në CV, kandidati asnjëherë nuk ka punuar pa ndërprerë në lëndën e caktuar në gjykata. Përkritazi me përvojën e punës, ai pati vërejtje edhe në pikën 4 të propozimvendimit për kandidatin Iljaz Ramajli. Në fund tha se këto janë vërejtjet që i kam për Ministrinë e Drejtësisë dhe kërkoi informacione shtesë për çështjen e Nerxhivane Dautit lidhur me dorëheqjen e saj dhe për përvojën e punës për kandidatët e propozuar në pikat 3 dhe 4 të propozimvendimit.

**Adem Salihaj** - Ishte i mendimit se për personin e propozuar në pikën 3 të propozimvendimit është mirë të kërkohen sqarime plotësuese se a i plotëson kushtet dhe nëse konstatohet se nuk i plotëson kushtet formale le të vijë një propozim tjetër në vend të tij. Edhe çështja e dorëheqjes së Nerxhivane Dautit le të qartësohet. Ajo në kërkesën drejtuar këtij komisioni thekson se s'ka dhënë dorëheqje, por ka kërkuar të jetë anëtare e Komisionit e jo zëvendëse. Tek anëtarët e propozuar në pikat 2 dhe 7 (Arsim Bajramin dhe Hajredin Kuqin) pati vërejtje. Ai tha se unë mendoj se Arsim Bajrami dhe Hajredin Kuqi nuk është mirë të jenë të propozuar për anëtarë të këtij komisioni për shkak të ngjyrimin të fortë politik që kanë.

**Džezair Murati** - Tha se Ruzhdi Berishën e njeh dhe se ka mendime shumë të mira për të, ndërsa për Nerxhivane Dautin, tha se ajo është deputete në tri mandate dhe i njeh aftësitë e saj. Ajo ka dhënë kontribut të madh në hartimin e ligjeve, mirëpo lidhur me dorëheqjen e saj është e nevojshme që ajo vetë të qartësojë a ka dhënë dorëheqje apo jo.

**Riza Smaka** - Lidhur me propozimin nën pikën 4 në të cilin anëtarë i Komisionit është propozuar Iljaz Ramajli, ndërsa zëvendëse Nerxhivane Dauti, tha se po të isha unë në vend të Iljaz Ramajlit, nuk do të pranoja të isha para profesoreshës Nerxhivane Dauti, sepse ajo është me kompetentja për këtë lëndë. Ai u angazhua të kërkohet nga Ministria e Drejtësisë që për anëtare të Komisionit për provimin e jurisprudencës të propozohet Nerxhivane Dauti, kurse zëvendës të jetë ndonjë kandidat adekuat me kushtet që kërkohen për këtë çështje.

**Adem Hjadaraj** - Lidhur me këtë propozimvendim theksoi se shumica e kandidatëve të propozuar janë njerëz të politikës, prandaj ne si Komision duhet ta kemi parasysh këtë çështje. Me këtë rast do të duhej të propozoheshin kandidatë pa funksione politike.

**Bajram Kosumi** - Tha se pajtohet për t'ia kthyer propozimvendimin Ministrisë së Drejtësisë për rishikim, me rekomandim që ta bëjë një propozim më gjithëpërfshirëse dhe për anëtarë të këtij komisioni të mos propozohen njerëz që janë në funksione ekzekutive.

**Adem Salihaj** - Tha se Komisioni është komision profesional që do t'i vlerësojë aftësitë e aplikuesve ose të konkurruesve, prandaj duhet t'u ikim ngjyrymeve politike dhe partiake, sepse mund të ketë komente dhe situata të ndryshme. Sa i përket Nerxhivane Dautit, theksoi se e çmon profesionalizmin e saj, por edhe Robert Muharremi është një kandidat brilant, jo vetëm për zëvendësanëtar, por edhe për anëtar. Ai propozoi që ky propozimvendim të mos miratohet, por t'i kthehet përsëri Ministrisë së Drejtësisë për të propozuar kandidatë pa ndikime politike që do ta përbëjnë një komision profesional.

**Bahri Hysen** - U përpoq ta sqaronte çështjen se ligji nuk e ndalon që anëtarët e propozuar për këtë komision të jenë anëtarë të partive politike. Ai për prof. Arsim Bajramin, tha se kush do të ishte në gjendje të pyeste për të Drejtën Kushtetuese më mirë se ai. Ky person ka qenë pjesëmarrës në hartimin e Kushtetutës dhe ligjërues i lëndës e Drejta kushtetuese në fakultet. Ai tha se provimi i jurisprudencës është provim profesional dhe në komision për këtë provim duhet të jenë anëtarët profesionistë dhe të përgatitur.

**Riza Smaka** - Lidhur me kryetarin e këtij komisioni tha se konkretisht propozoj që Rexhep Haxhimusa të mos jetë kryetar i Komisionit, sepse është kryetar i Gjykatës Supreme dhe kryetar i Këshillit Gjyqësor dhe nuk është fare në rregull që këtu të bëhet shumëfishimi i funksioneve.

Pas diskutimeve të shumta, pothuaj të të gjithë anëtarëve, përkitazi me propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të judikaturës Komisioni e nxori këtë

## **P e f u n d i m**

1. Të kërkohet nga Ministria e Drejtësisë rishikimi i bazës juridike të propozimvendimit për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të judikaturës konform nenit 7.6 të Ligjit për provimin e judikaturës;

2. Të kërkohen informacione shtesë për përvojën në punë në pajtim me nenin 7.6 të ligjit të lartpërmendur për kandidatët Ruzhdi Berisha dhe Iljaz Ramajli, të propozuar për anëtarë të Komisionit për dhënien e provimit të judikaturës;

3. Të kërkohet nga Ministria e Drejtësisë informacion lidhur me dorëheqjen e Nerxhivane Dautit nga pozita e zëvendësanëtarit të Komisionit për dhënien e provimit të judikaturës.

#### **6. Të ndryshme:**

- Shqyrtimi i kërkesës së Nerxhivane Dautit;
- Njoftimi i Komisionit për Analizën ligjore të OSCE-së për rastet e trafikimit me njerëz në Kosovë
- Shqyrtimi i rekomandimit të grupeve të punës të komisioneve për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë publikë

Lidhur me kërkesën e Nerxhivane Dautit u diskutua dhe u vendos në pikën paraprake të rendit të ditës. Kurse për Analizën ligjore të OSCE-së për rastet e trafikimit me njerëz në Kosovë Komisioni u njoftua në pikën e parë të rendit të ditës.

Komisioni e shqyrtoi edhe rekomandimin e grupeve të punës të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Projektligjin për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë.

Kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni, i njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin e grupeve të punës të këtyre dy komisioneve. Ai tha se Komisioni për Buxhet e Financa nuk ka qenë në gjendje ta jepte asnjë propozim, por kemi ardhur në përfundim që Projektligji të procedohet në formën e propozuar. Por pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pas nxjerrjes së Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe pas nxjerrjes së Ligjit për Prokurorinë Publike dhe të ligjeve të tjera, të analizohet mundësia e zgjerimit të përfituesve nga ky ligj. Pas shqyrtimit të këtij raporti, Komisioni e nxori këtë

### **P ë r f u n d i m**

1. T'i procedohet Kuvendit për miratim Projektligji për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë publikë **L-001** me amendamente në formën e propozuar, që u është shpërndarë deputetëve më 24 prill 2008;
2. Të analizohet mundësia e zgjerimit të numrit të përfituesve nga ky ligj pas nxjerrjes së Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, të Ligjit për Prokurorinë Publike dhe të ligjeve të tjera të Republikës së Kosovës.

*Procesverbalin e hartoi: stafi mbështetës i Komisionit*

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00*

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni